VENDIM
Nr. 448, datë 13.7.2007

PËR RRITJEN E PENSIONEVE
(Ndryshuar me VKM nr. 501, datë 16.8.2007)
(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 88 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rritjen, në masën 5 për qind të:

a) pensioneve të plota, të pjesshme dhe të parakohshme, të pleqërisë, të pensioneve për merita të veçanta dhe për vjetërsi shërbimi, pensioneve të invaliditetit dhe pensioneve familjare, të caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar pensionet e caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

b) pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore, të caktuara në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

c) shtesës mujore, të përfituar në përputhje me vendimin nr.326, datë 21.6.1993 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar";

ç) pensioneve të caktuara me dekretin nr.758, datë 1.2.1994 të Presidentit "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut", miratuar me ligjin nr.7799, datë 24.2.1994.

2. Rritjen, në masën 10 për qind të:

a) pensioneve, të plota dhe të pjesshme, të pleqërisë, të pensioneve të invaliditetit dhe pensioneve familjare, të caktuara në përputhje me ligjin nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë";

b) pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

3. Rritja e pensioneve, e parashikuar në këtë vendim, të zbatohet edhe për shtesat mbi pension, të dhëna në përputhje me nenet 33, 38 e 39 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe me nenin 24 të ligjit nr.4171, datë 13.6.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë".

4. Rritje, sipas parashikimeve në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, përfitojnë edhe pensionet, të cilat caktohen nga data 1.7.2007 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 30.6.2007, përfshirë edhe këtë datë.

5. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të këtij ligji, që kanë datë fillimi nga 1.7.2007 e në vazhdim, nuk caktohen më pak se 8 650 (tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj dhe më shumë se 17 300 (shtatëmbëdhjetë mijë e treqind) lekë në muaj.

6. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me datë fillimi nga

1.7.2007 e në vazhdim, nuk mund të caktohen më pak se 4 520 (katër mijë e pesëqind e njëzet) lekë në muaj.

7. *Pensionistët, që përfitojnë pensione pleqërie, pensione invaliditeti dhe pensione familjare, të caktuara sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar ata të caktuar sipas paragrafit të katërt, të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, edhe pas rritjes së pensionit, në masën 5 për qind, do të vazhdojnë të marrin kompensimin e të ardhurave, në atë masë, që e kanë përfituar sipas vendimit nr.763, datë 27.12.2006 të Këshillit të Ministrave "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve".*

8. Pensionistët, që përfitojnë pensione në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, do të vazhdojnë të marrin kompensimin e të ardhurave, në atë masë, që e kanë përfituar nga zbatimi i vendimit nr.17, datë 20.1.2007 i Këshillit të Ministrave "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve të fshatit".

9. *Nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim të:*

a) kompensohen, sipas kritereve dhe masës së përcaktuar në vendimin nr.763, datë 27.12.2006 të Këshillit të Ministrave "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve", pensionistët, që do të përfitojnë pensione të plota pleqërie, invaliditeti ose familjare, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar ata të caktuar sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të këtij ligji, kur të ardhurat mujore të tyre janë deri në 10 410 lekë.

Ndërsa të ardhurat e pensionistëve, që do të marrin pensione të pjesshme, kompensohen në proporcion, ndërmjet pensionit individual dhe pensionit të plotë minimal, por jo më shumë se 760 lekë në muaj.

b) kompensohen, sipas kritereve dhe masës së kompensimit, të përcaktuar në vendimin nr.17, datë 20.1.2007 të Këshillit të Ministrave "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve të fshatit, pensionistët, që do të përfitojnë pensione të plota pleqërie, invaliditeti ose familjare, sipas sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, kur të ardhurat mujore të tyre janë deri në 5 410 lekë. Ndërsa të ardhurat e pensionistëve, që marrin pensione të pjesshme, kompensohen në proporcion, ndërmjet pensionit individual dhe pensionit të plotë, por jo më shumë se 690 lekë në muaj.

10. Efektet financiare për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 915 milionë lekë dhe përballohen nga fondi i kontigjencës, i caktuar në buxhetin e shtetit të vitit 2007, për rritjen e pensioneve.

11. Shpenzimet për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve nga Posta Shqiptare sh.a., përllogariten në shumën 30 milionë lekë dhe të përballohen nga fondi i kontigjencës, i caktuar në buxhetin e shtetit, të vitit 2007, për rritjen e pensioneve.

12. Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë udhëzim për procedurat e zbatimit të unifikuar të këtij vendimi me vendimet nr.763, datë 27.11.2006 "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve" dhe nr.17, datë 20.1.2007 "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve të fshatit", të Këshillit të Ministrave.

13. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha